



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Nr. 715 prot.

Tiranë, më 18.06 2019

V E N D I M

Nr. 2, datë 12.06 2019

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR SHKARKIMIN E UJIT”, ME OBJEKT  
“REALIZIMI I PROVËS SË HERMETIZIMIT I GAZSJELLËSIT  
TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)”**

Në mbështetje të shkronjës “c” të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit nr.416, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes “Për shkarkimin e ujit”, subjektit “Trans Adriatic Pipeline AG”, me objekt “Realizimi i provës së hermetizimit i Gazsjellësit Trans Adriatik Pipeline (TAP)”.
2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE

